

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Mbyllim kapitujt brenda vitit 2027", Fino: Sfida më e madhe "Themelorët" dhe siguria ushqimore
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/mbyllim-kapitujt-brenda-vitit-2027-fino-sfida-me-e-madhe-themeloret-dhe-i588528
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 11:43:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 11:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	82759679f73e4c8640826a4e667f56e9a23acbf0acab20001016b3de25471f7e
TEKSTI	88830711c53b17173fae638ed3036eb75acae5440822ae3591856d08b705c184
PAMJA	f9fd40a575ab15cec20332ac68640b44f13cfa12565b84d8dcfda459bcb4b9a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	554c8a62b721ce510fb8fe187a1c11c02fdafa965a185d552a661d22287ac169
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/554c8a62b721ce510fb8fe187a1c11c02fdafa965a185d552a661d22287ac169>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie "Mbyllim kapitujt brenda vitit 2027", Fino: S'ida me e madhe "Themeloret" dhe siguria ushqimoreShtohen telashet per Granit Xhakes, dyshohet se perdori certifikaten e fundit

"Mbyllim kapitujt brenda vitit 2027", Fino: S'ida me e madhe "Themeloret" dhe siguria ushqimore



26 Shtator 2026, 13:40Politika TEMA



Brukseli zyrtar e shikon pozitivisht punën që Shqipëria po bën sa i përket negociatave për Bashkimin Europian. Për Vizion Plus, zv.ministrja e Jashtme Megi Fino, shprehet se mbyllja e tre grupkapitujve të parë ishte vetëm fillimi, ndërsa Tirana zyrtare pret sinjalin e radhës.

"Padyshim që mbyllja e tre kapitujve në korrik të këtij viti nuk ishte një rast i vetëm. Sigurisht që ne presim që do të ketë edhe raste të tjera që padyshim me këtë ritëm dhe në kuadër të këtij plani pune që kemi dakordësuar me Komisionin Europian", u shpreh Fino.

Ajo thekson se mbajtja e këtij ritmi aktual mund të bëjë të mundur arritjen e objektivit për të mbyllur të gjithë grupkapitujt brenda vitit 2027, synim ky i dakordësuar edhe me Komisionin Europian.

"Kemi parë që në më pak se dy vjet, janë hapur të gjithë grupkapitujt, janë mbyllur tre kapituj, tanimë kemi bërë progres edhe me piketat e ndërmjetme. Puna vazhdon, është e përditshme, jo vetëm për ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, është një punë që i përket të gjithë qeverisë shqiptare dhe administratës. Pikë së pari padyshim për ne është mbajtja e këtij momentumit apo këtij ritmi dhe këtij angazhimi që ne e kemi maksimal. Vullneti i qeverisë është maksimal", thotë Fino.

Por cilët sektorë janë më sfiduesit për vendin tonë? Zv.ministrja Fino rendit disa prej tyre nga "Themeloret" e deri tek "Siguria Ushqimore".

"Mund të përmendja grupkapitullin e themeloreve. Padyshim kapitujt 23 dhe 24 i cili vendos dhe ritmin pak a shumë të të gjithë kornizës negociuese sepse është grupkapitulli që hapet i pari dhe mbyllet i fundit. Padyshim që për sa i përket kapitujve të bujqësisë dhe zhvillimit rural apo sigurisë ushqimore apo mjedisi. Janë tema dhe janë sektorë të rëndësishëm të cilat prekin dhe kërkojnë kapacitete të shumta në nivel qendror por edhe vendor", thotë ajo.

Në korrik, vendi ynë zhvilloi konferencën ndërqeveritare BE-Shqipëri, ku u mbyllën 3 kapitujt e parë, "Shkenca dhe Kërkimi", "Arsimi dhe Kultura" si dhe "Marrëdhëniet me Jashtë".

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Eric Wendt mbërrin në Pallatin e Brigadave për ceremoninë e nisjes së mandatit si Ambasador i SHBA në Tiranë](#)

Tabaku: Korrupsioni është taksë e fshehtë që paguan çdo shqiptar

09:30 Politika

[Eric Wendt nis sot misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, do t'i dorëzojë letrat kredenciale Begajt](#)

08:30 Politika / 3 komente

[Fjala e PLOTË/ Edi Rama në OKB: Makineria e Inteligjencës Artificiale do të bindet, pyetja është 'kujt'](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.